

JOSIF MITA

STRUKTURA LEKSIKORE DHE STRUKTURA EKSPRESIVE E GJUHËS NJERËZORE

1. Sintaksë do të thotë ndërtim fjalish: si grupohen fjalët bashkë për të ndërtuar sintagma dhe fjali. Në greqishte *syntaxis* do të thotë *të vësh bashkë*. Kur themi *të vësh bashkë*, nuk është e njëjtë sikur të vëmë bashkë tullat për të bërë një mur ose frutat dhe sheqerin për të bërë reçel. Të folurit është një proces shumë i ndërlikuar.

Koncepti *të vësh bashkë* kuptohet më mirë në muzikë. Muzika ka një sintaksë kombinatorë, sepse këtu notat vendosen bashkë në një mënyrë shumë të përcaktuar. Notat në muzikë janë si fjalët e gjuhës. Tangoja, valsi, ose vallet e popujve të ndryshëm kanë sintaksën e tyre, kanë një mënyrë të veçantë për të vendosur gjërat së bashku.

Marler-i¹ dallon **sintaksën fonologjike** dhe **sintaksën leksikore**. Sipas tij, të vësh gjërat bashkë zbatohet së pari në fonologji. Fonologjia vendos fonemat bashkë për të bërë rrokjet e strukturuara. Çdo gjuhë ka sintaksën e saj fonologjike ose modelet e tingujve. Në fonologji, njësitë në vetvete të vendosura së bashku nuk kanë asnjë kuptim. P.sh., fonema /m/ në vetvete nuk ka kuptim. Po kështu edhe fonemat e tjera. Si pasojë, rrokjet që formohen nga fonemat nuk e marrin kuptimin e tyre nga këto të fundit, sepse thamë që fonemat në vetvete nuk kanë kuptim. Emri *mal* nuk e merr kuptimin nga kuptimet e brendshme të të tri fonemave /m/, /a/ dhe /l/. Sintaksa fonologjike është vendosja bashkë e gjërave pa kuptim për të formuar njësi më të mëdha.

Këngët e zogjve, këngët e balenave etj. janë sintaksë fonologjike. Pra, është e mundshme që ndonjë aftësi sintaksore fonologjike të zhvillohet tek këto genie të gjalla pavarësisht nga kuptimi.

Sintaksa leksikore, siç e quan Marler-i është ajo lloj që i vë gjërat bashkë ku elementet kanë njëfarë kuptimi dhe e gjithë ajo që përftohet ka kuptim në të cilin përfshihen kuptimet e pjesëve të veçanta. Kuptimet e ndërlikuara shprehen duke vendosur së bashku njësi më të vogla me kuptim. Këtë aftësi e kanë vetëm njerëzit. Asnjë kafshë nuk ka gjuhë si një sistem komunikimi që ia ka

¹ P. Marler, *Animal communication and human language*, në N. G. Jablonski and L. C. Aiello (eds.), "The Origin and Diversification of Language", San Francisco, CA: California Academy of Sciences, 1998, f. 1-19.

dhënë natyra, asnjë kafshë nuk është e aftë të mësojë gjuhën e njeriut, edhe pse ne mund të bëjmë shumë përpjekje për t'ia mësuar.

Një shembull i komunikimit të kafshëve janë bletët. Edhe pse shumë larg gjenetikisht nga njeriu, bletët përdorin një sistem komunikimi të çuditshëm. Bletët e dallojnë vendin e ushqimit me anë të një vektori që ka dy përbërës: një përbërës largësie dhe një përbërës drejtimi. Po bletët nuk e mendojnë më parë vendin ku duhet të shkojnë, ashtu si njeriu që mund ta shikojë në një hartë. Duke fluturuar në një largësi të caktuar dhe në një drejtim të caktuar, veprimi i bletëve është i njëjtë me atë të një roboti.

Këngët e disa kafshëve të egra janë një sjellje e çuditshme sintaksore. Shumë studiues kanë parë në këtë sjellje fillimet e sintaksës së njerëzve. Sipas tyre, lidhja qëndron në ndërlikimin sintaksor të këtyre këngëve. Të parët e njeriut këndonin këngë të ndërlikuara njëllor si këngët e zogjve. Këtë ide e besonin Rusoi dhe Darvini, gjithashtu edhe Otto Jespersen-i, një gjuhëtar i njohur që jetoi në fillimet e shekullit të njëzetë. Të gjithë ata e shikonin muzikën si një lloj shprehjeje sintaksore të ndërlikuar nga e cila më vonë u zhvillua gjuha e kuptimshme.

Aftësia për këngë të ndërlikuara hodhi bazat për sintaksën fonologjike, por jo bazat për sintaksën semantike të fjalisë.

2. Gjuha njerëzore duket se është zhvilluar në njëqind mijë vitet e fundit dhe nuk ka pasur përparime të dukshme qysh kur stërgjyshërit tanë u shpërngulën nga Afrika, rreth 50,000 – 80,000 vjet më parë. Gjuha lindi nga kombinimi i dy sistemeve më të thjeshta. Sistemi i parë, që quhet tipi E (për *ekspresiv*) gjendet në këngët e zogjve. Sistemi i dytë quhet tipi L (për *leksikor*). Sintaksa e gjuhës njerëzore i bashkon këta dy sisteme në një sistem të vetëm duke lidhur elemente të sistemit leksikor me ato të sistemit ekspresiv. Shembulli i mëposhtëm

Çfarë_i mendon se Drita i ka dhuruar ____i Agimit?

ilustron se si lidhen sistemi ekspresiv dhe sistemi leksikor. Sintagma *çfarë* në fillim të fjalisë është në një vend *ekspresiv* pyetjeje, por ajo gjithashtu ka një vend semantik si argument i foljes, pra ajo është në një vend *leksikor* pas foljes *dhuroj* ku merr edhe një përmbajtje me kuptim. Lidhje të tilla janë si një urë ndërmjet shtresës leksikore dhe shtresës ekspresive të fjalisë. Të gjitha gjuhët njerëzore i kanë këto dy shtresa².

Kuptimi leksikor i fjalisë

² N. Chomsky, *The Minimalist Program*. Cambridge, MA: The MIT Press, 1995; S. Miyagawa, *Why Agree? Why Move?: Unifying Agreement-Based and Discourse-Configurational Languages*. Cambridge, MA: The MIT Press (2010).

Agimi bleu një libër

del nga fjalët *Agimi, blej, një libër*.

Struktura leksikore e fjalisë

Çfarë bleu Agimi?

ka në fillim të saj fjalën *çfarë* e cila e bën fjalinë pyetëse. Duke u nisur nga struktura leksikore e fjalisë *Agimi bleu një libër*, ne formojmë fjalinë pyetëse *çfarë bleu Agimi? Struktura leksikore* formohet prej pikave leksikore që kanë pavarësi dhe nuk janë të kufizuara. Përkundrazi, *struktura ekspresive* përbëhet prej një numri të kufizuar elementesh që njihen si elemente funksionale, të cilët nuk mund të jenë të pavarur. Siç shihet, fjalitë mund të kenë një shtresë të jashtme që paraqet strukturën ekspresive dhe një shtresë të brendshme që paraqet strukturën leksikore.

Lidhja ndërmjet këngës së zogjve dhe gjuhës së njeriut është vënë re qysh herët. Rreth 2000 vjet më parë Aristoteli në veprën e tij *Historia Animalium*³ kishte vënë re ngjashmëri të theksuara ndërmjet këngës së zogjve dhe të folurit të njeriut. Po çfarë dëshmon kënga e zogjve për strukturën dhe për evolucionin e gjuhës së njeriut?

Sipas variantit të Marler-it, kënga e zogjve ka vetëm sintaksë fonologjike, d.m.th. vendosjen së bashku të elementeve sipas disa gjedheve të përcaktuara, por e tërë vijimësia që krijohet nuk ka kuptim që del nga kuptimi i elementeve të veçantë që vendosen së bashku. Përkundrazi, sipas Marler-it vetëm gjuha e njeriut ka sintaksë leksikore. Vetëm në gjuhën e njeriut pjesët që kombinohen krijojnë një kuptim që është i ndryshëm nga kuptimi i pjesëve fillestare. Me një fjalë, sipas Marler-it, si kënga e zogjve, ashtu edhe gjuha e njeriut që të dyja kryejnë kombinime, në kuptimin që të dyja krijojnë struktura më të gjera prej pjesëve më të vogla, por vetëm në gjuhën e njeriut kuptimi i një fjale apo i një fjalie ndryshon në qoftë se ndryshojnë pjesët përbërëse. Elementet e këngëve të zogjve nuk kombinohen kurrë për të dhënë *kuptime* të reja. Në këngën e zogjve mungojnë pikat leksikore, *fjalët*, që janë të pranishme në gjuhën e njeriut. Pavarësisht nga shumëllojshmëria e tyre, këngët e zogjve kanë një rreth të kufizuar qëllimesh, kryesisht ato që lidhen me riprodhimin. Në këtë kuptim, këngët e zogjve kanë vetëm mesazhe dhe jo kuptime. Një sistem i tillë gjuhësor është i tipit E (ekspresiv), pa kuptime.

Në gjuhën njerëzore, në nivelin e fjalëve, rrënja e fjalës përputhet me shtresën L, ndërsa elementet që kanë tiparet kategoriale (emër, folje, mbiemër)

³ Aristotle, *Historia Animalium*, përkthyer nga J. Peck. Cambridge, MA: Harvard University Press, 1984.

dhe tiparet e eptimit (numri, rasa, koha etj.) përbëjnë shtresën E. Këto shtresa lidhen me një rregull që quhet **shkrirje**. Kështu, fjalët nuk janë fillestaret në sintaksë, por janë të prejardhura me anë të shkrirjes. Fjala brenda saj shpesh është aq e ndërlikuar sa edhe vetë fjalia.

Që të dy tipat (L dhe E) gjenden në çdo fjalë apo fjali të gjuhës, sepse çdo fjalë apo fjali ka dy shtresa kuptimi: një strukturë leksikore që mban kuptimin leksikor dhe një strukturë ekspresive që përbëhet nga elementet funksionale që i japin formën shprehjes. Në fjalëformim rrënja është shtresa leksikore dhe informacioni kategorial dhe gramatikor që vendoset sipër rrënjës është shtresa ekspresive. Meqenëse tek rrënja mungon kategoria sintaksore (p.sh. emër, folje ose mbiemër), ajo është një njësi gramatikore e lirë që nuk ka të bëjë drejtpërdrejt me sintaksën. Operacionet sintaksore realizohen me fjalë që kanë elemente kategoriale dhe gramatikore. Kështu, në nivelin e fjalës shkrirja realizohet duke kombinuar rrënjët (tipin L) me tiparet kategoriale dhe gramatikore (tipi E).

Një rrënjë nuk mund të kombinohet drejtpërsëdrejti me një rrënjë tjetër, meqenëse tek rrënja mungojnë tiparet gramatikore. Kështu, njësitë leksikore nuk mund të kombinohen me njëra-tjetrën për të formuar thjesht struktura hierarkike leksikore. Siç kuptohet, gramatika nuk lejon që të bashkohen thjesht njësitë e tipit L. Gramatika lejon vetëm njësitë e tipit E-L ku E mban shtresën gramatikore, e cila lejon që elementet të kombinohen me njëri-tjetrin.

Faza fillestare e gjuhës përbëhet vetëm nga elementet rrënjë, që ishin të izoluar nga njëri-tjetri. Kjo fazë është e krahasueshme me pëllitjet e gomarëve, të cilat kanë një referim në botën reale, por nuk kanë tipare gramatikore siç është kategoria p.sh. Kështu, tek gomarët nuk mund të bëhet fjalë për ndonjë sistem kombinues. Një sistem të tillë e gjejmë tek gjuha e njeriut që kombinon pikërisht të dy sistemet (E dhe L). Forma më e thjeshtë e këtij kombinimi është kur shkrihen një anëtar i E dhe një anëtar i L duke formuar kështu kompletin {E, L}. Në nivelin e fjalëve rrënjët kombinohen me disa tipare gramatikore. Duke pasur tiparet gramatikore *ffjala* merr pjesë në proceset kombinuese siç janë fjalët e përbëra dhe sintaksa. Kjo mund të ilustruhet në gjuhën tonë me realizimin e disa morfemave të eptimit që janë të veçanta për disa kategori sintaksore në pjesët e një fjale të përbërë. P.sh., tek fjalët e përbëra *luledielli*, *luledhensh*, pjesa e dytë është në rrjedhore, kështu që nuk kemi të bëjmë me rrënjë.

3. Gjuha e njeriut ndryshon nga kënga e zogjve në dy pika kryesore: 1) gjuha e njeriut ka sintagma, 2) sintagmat e gjuhës së njeriut kanë strukturë hierarkike. Ata që nuk kanë studiuar për gjuhësi, kur shikojnë diagramet pemë të strukturës së fjalisë habiten dhe u duket diçka e pamundur për ta kuptuar, njëlloj si ata që nuk kanë studiuar matematikën mbeten të hutuar përpara një formule të ndërlikuar. Për sa i takon strukturës së fjalisë, nuk është shumë e vështirë ta kuptosh. Ç'do të thotë që një fjali ka një strukturë hierarkike?

Sintaksa studihet duke analizuar fjalitë, ashtu si anatomia studihet duke parë konkretisht organet e njeriut.

Organizimi hierarkik është një strukturë pjesa-e tëra që mund të jetë shumë e ndërlikuar, ku pjesët kanë nënpjesë, nënpjesët nga ana e tyre kanë përsëri nënpjesë e kështu me radhë. Fjalja *macja ndoqi miun* është hierarkike. Fjalja ndahet në dy pjesë: në të majtë është një sintagmë emërore (SE) *macja*, ndërsa në të djathtë është një sintagmë foljore (SF) *ndoqi miun*. Sintagma foljore në vetvete ndahet në dy pjesë: folja *ndoqi* dhe sintagma emërore *miun*. Kështu sintagma emërore e fillimit *macja* ndodhet sipër sintagmës së dytë *miun*. Sintagma e dytë *miun*, që zakonisht quhet kundrinor i drejtë, formon një sintagmë me foljen, sepse folja së bashku me kundrinorin e drejtë u nënshtrohen disa rregullave sintaksore që i trajtojnë ato (folja së bashku me kundrinorin) si një njësi të vetme, ashtu si atomet, të cilët u nënshtrohen të njëjtave reaksione kimike, bashkohen në një molekulë të vetme. Gjuhëtarët kanë vërtetuar që një “përbërje kimike” e tillë është edhe në gjuhë. Më e rëndësishmja është se lidhje të tilla sintaksore nuk varen nga renditja e fjalëve në vijë të drejtë; mund të themi edhe *miun* ndoqi *macja* dhe këto lidhje dalin përsëri. Kjo tregon që të gjitha lidhjet sintaksore në fjali varen nga veçoritë hierarkike të strukturës së fjalisë dhe nuk kanë të bëjnë me fqinjësinë e fjalëve ndaj njëra-tjetrës.

Natyra hierarkike e paraqitjeve sintaksore është e lidhur me karakterin përsëritës të sintaksës. Tek kënga e zogjve mungon përsëritja që është aq shumë e pranishme në gjuhën e njeriut. Tashmë dihet që në gjuhën e njeriut një sintagmë mund të jetë brenda një sintagme tjetër dhe një përsëritje e tillë vazhdon pafund.

Çomski tregoi se nocionet bazë të teorisë së funksioneve përsëritëse, që bëhen në matematikë, mund të merren edhe në gjuhë. Një procedurë përsëritëse është ajo që mund të rizbatohet në mënyrë të pafundme duke nisur nga pikënisja e saj, duke krijuar struktura hierarkike. Shembujt e mëposhtëm ilustrojnë disa raste të përsëritjes në gjuhë ku një sintagmë mund të ndërfitet në një sintagmë të tjetër tip. Kjo mund të bëhet pafundësisht:

Parathënia [e librit të parë [për zbulimin [e ...]]]
 Besoj [që njerëzit pyesin [nëse Agimi mendon [se dikush ka thënë ...]]]
 Takova [djalin [që bleu [librin [i cili kënaqi [kritikët [që shkroi
 [intervistën ...]]]]]]].

Vini re se nuk është thjesht përsëritja e procedurës që e bën atë të rishfaqet, por është aftësia e saj për të krijuar një strukturë hierarkike, siç ndodh në nivele të ndryshme të organizimit të strukturës gjuhësore. Kështu p.sh. përsëritja e programit motor që aktivizohet kur ecim, një hap pas një tjetri, mund të vazhdojë pambarimisht, por kjo nuk krijon ndonjë strukturë hierarkike.

Këtu duhet të bëjmë një vërejtje të rëndësishme: përsëritja në gjuhën e njeriut është e pranishme tek struktura leksikore, por jo tek struktura ekspresive. Kështu, struktura ekspresive e gjuhës së njeriut është e ngjashme me atë të këngës së zogjve. Siç kuptohet, lidhja ndërmjet këngës së zogjve dhe gjuhës së njeriut nuk është ndërmjet këngës dhe gjuhës të marra si tërësi, por vetëm ndërmjet këngës së zogjve dhe strukturës ekspresive të sintaksës së gjuhës së njeriut.

Një veçori tepër e rëndësishme e njohurive të njeriut për gjuhën është edhe aftësia krijuese që duket në përdorimin e përditshëm të gjuhës. Ne vazhdimisht prodhojmë dhe kuptojmë objekte gjuhësore të reja, fjali që kurrë nuk i kemi ndërtuar në përvojën tonë gjuhësore të mëparshme dhe aftësitë gjuhësore që kemi na japin mundësinë për të shprehur një numër të pafund mesazhesh. Këtë sistem komunikimi me veçori të tilla nuk e ka asnjë lloj tjetër. Rëndësia e aspektit krijues të gjuhës nuk është diçka e re. Kjo ka qenë e qartë qysh në shekullin e shtatëmbëdhjetë. René Descartes thoshte se aftësia për të organizuar fjalët në një numër të pafundmë fjalish dallon njeriun më budalla prej bletës më inteligjente dhe prej makinës më të ndërlikuar. Sipas tij *edhe njerëzit më të ngathët nga mendja janë në gjendje të vendosin disa fjalë bashkë dhe të formojnë një thënie në mënyrë të tillë që mendimet e tyre të kuptohen, por nuk gjendet asnjë kafshë, sado e përsosur që të jetë, që mund të bëjë të njëjtën gjë*⁴.

Në gjysmën e parë të shekullit të njëzetë, gjuhësia strukturaliste e konceptonte gjuhën (*langue* e Sosyrit) si një inventar shenjash gjuhësore, secila nga të cilat përbëhet prej një çifti tingull-kuptim. Megjithatë, një inventar është gjithmonë i kufizuar. Ky variant nuk qe i aftë të kuptonte çështjen themelore të aftësisë krijuese, por vetëm sa dha disa nocione të paqarta të analogjisë: kombinimet e mundshme të pafundme të shenjave gjuhësore nga Sosyri u paraqitën si *fjalë* (parole), aktualizimi i sistemit të gjuhës në akte gjuhësore individuale, ndërsa gjuha përmbante një repertor idiomash të ngrira dhe jo një sintaksë produktive. Ndoshta edhe vetë Sosyri nuk ishte i kënaqur me këtë përfundim, siç e tregojnë disa lëkundje të tij në *Cours de linguistique générale*⁵.

Një veçori tjetër e gjuhës së njeriut është etiketimi; kategoria e një fjale (emër, folje etj.) formon etiketën e një sintagme më të madhe që e përmban


⁴ R. Cartesio (1637), *Discorso sul metodo*, përkthyes Cubeddu, Italo, Collezione: Le idee, 9; Editori Riuniti, Roma, 1996.; (https://www.liberliber.it/mediateca/libri/d/cartesio/discorso_sul_metodo/pdf/discorso_sul_metodo.pdf)

⁵ F. de Saussure, *Course in General Linguistics* (botuar nga Charles Bally dhe Albert Sechehaye në bashkëpunim me Albert Riedlinger, përkthyer dhe pajisur me shënime nga Roy Harris), Duckworth, 1983.

fjalën. P.sh., tek fjalët *ha* dhe *mollë* folja *ha* etiketon sintagmën më të madhe *ha mollë* që njihet si sintagmë foljore.

Në këtë mënyrë, sintagmat në gjuhën e njeriut kanë të njëjtën veçori të pikës leksikore që etiketon sintagmën. Kjo gjë bën që gjuha e njeriut të ketë aftësinë që nuk gjendet në asnjë lloj tjetër gjuhe: të formojë struktura hierarkike⁶.

Etiketimi është veçori vetëm e gjuhës së njeriut. Ai ndodh tek të gjitha llojet e sintagmave. Megjithatë, gjuha e njeriut në këtë pikë nuk është pa kufizime. Struktura ekspresive ka të bëjë vetëm me sintagmën e lidhëzës, ku e kanë vendin disa shprehje ekspresive si pyetja, fokusi, topika. Sintagma e lidhëzës duhet të ndodhet gjithnjë sipër sintagmës së kohës dhe jo e kundërta. Gjithashtu, sintagma e lidhëzës është një dhe e vetme dhe nuk mund të përsëritet. Struktura është si më poshtë:



Kjo tregon që struktura ekspresive është e tipit E dhe është e njëjtë me strukturën ekspresive të këngës së zogjve.

Figura e mëposhtme tregon se si bashkëvepron struktura ekspresive me strukturën leksikore. Trekëndëshi që ndodhet sipër tregon strukturën ekspresive, ndërsa trekëndëshi që ndodhet poshtë tregon strukturën leksikore.




Si funksionojnë këto dy shtresa? Dy veçoritë e gjuhës së njeriut që kohët e fundit kanë tërhequr vëmendjen e gjuhëtarëve, lëvizja dhe përshtatja, kanë të

⁶ N. Chomsky (2008), *On phases*, në “Foundational Issues in Linguistic Theory”, botues R. Freidin, C. P. Otero and M. L. Zubizarreta (Cambridge, MA: The MIT Press), f. 133-166; N. Hornstein, *A Theory of Syntax: Minimal Operations and Universal Grammar*, Cambridge: Cambridge University Press, 2009.

përbashkët ndërmjet tyre veçorinë që të lidhin një pikë prej një shtrese me një pikë tjetër të një shtrese tjetër (Miyagawa, 2010), duke bashkuar kështu të dyja shtresat.

Lëvizja e sintagmave ndodh gjithnjë prej strukturës leksikore në strukturën e shprehjes si në figurën e mëposhtme:



Atëherë mund të themi se lëvizja ekziston për të njëzuar strukturën e shprehjes dhe strukturën leksikore të gjuhës së njeriut.

SUMMARY

LEXICAL STRUCTURE AND EXPRESSIVE STRUCTURE OF HUMAN LANGUAGE

The language was born from the combination of two simpler systems. The first system, called type E (for expressive) is found in bird songs. The second system is called type L (for lexicon). The expressive structure concerns only the syntagma of the conjunction, in which there are some expressive expressions such as query, focus, topical. Only human language has a lexical syntax. Bird songs lack lexical points, words, which are present in human language. Grammar does not simply allow the union of L-type units. Grammar only allows E-L units. Bird songs lack the repetition that is so present in human language. Repetition in human language is present in the lexical structure, but not in the expressive structure. Therefore, the expressive structure of human language is similar to that of birdsong. The syntagmatic movement always occurs from the lexical structure to the structure of expression. Movement unifies the structure of expression and the lexical structure of human language.